



VENDIM

Nr. 128 Datë 11.09.2012

PËR

**PROCEDIMIN ADMINISTRATIV PER VENDOSJE GJOBE NDAJ
SHOQERISE CEZ SHPERNDARJE SH.A.**

Në mbështetje të nenit 99 e ne vijim te Kodit te Procedurave Administrative, Ligjit nr. 9072, date 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, te ndryshuar, neni 64 pika 1, germa g) dhe gj) dhe Ligjit nr. 10279, date 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.09.2012, mbasi shqyrtoi relacionin e grupit te punes bashkelidhur ketij vendimi, duke konstatuar qe CEZ Shpërndarje ka shkelur kuadrin ligjor ne fuqi:

- Ligjin nr. 9072, date 22/05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”
- VKM nr.338 date 19.03.2008 “Modelin Shqiptar te Tregut te Energjise Elektrike” i ndryshuar
- Vendimin e Bordit te Komisionerve te ERE-se, nr. 68, date 23.06.2008 “Rregullat e Tregut te Energjise Elektrike”, te ndryshuar ;

Vendosi :

1. Ndëshkimin me gjobe te CEZ Shpërndarje ne masën 1 % te te ardhurave vjetore te vitit paraardhës qe i korrespondojnë vlerës 430 milione leke per mos

prokurimin e energjise elektrike per mbulimin e gjitha humbjeve ne sistemin e shperndarjes per vitin 2012.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes se Konsumatorit të njoftojë CEZ Shperndarje lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.